



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Kuvendit

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, me 21 qershor 2010, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni - Kaloshi, Kolë Berisha, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Ahmet Isufi, dhe Vladimir Todorovic.

Munguan: Suzan Novobrdaliu, Besa Gaxherri dhe Dzezair Murati.

Pjesëmarrës të tjerë: Isuf Zejna - KDI, Floriana Shala - OSBE, Rinor Beka-NDI.

Nga Divizioni për mbështetje komisioneve parlamentare: Visar Krasniqi dhe Manush Krasniqi

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni - Kaloshi - kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.05.2010;**
- 3. Miratimi i Raportit për zbatimin e masave të Planit të Veprimit lidhur me rekomandimet e Raportit të Progresit;**
- 4. Shqyrtimi i praktikave parlamentare të Kuvendit të Kosovës;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.05.2010;

Procesverbali nga mbledhja e datës 26 maj 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit për zbatimin e masave të Planit të Veprimit lidhur me rekomandimet e Raportit të Progresit;

Kryetari, i paraqiti ndryshimet dhe plotësimet e bëra në Raportin për zbatimin e masave të Planit të Veprimit lidhur me rekomandimet e Raportit të Progresit dhe rekomandojë miratimin e tij.

Anëtarët e Komisionit nuk kishin vërejtje në këtë raport.

Komisioni pas shqyrtimit të Raportit, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Raporti për zbatimin e masave të Planit të Veprimit lidhur me rekomandimet e Raportit të Progresit, i njëjti procedohet tutje.

4. Shqyrtimi i praktikave parlamentare të Kuvendit të Kosovës;

Kryetari ngriti disa shqetësime lidhur me punën e mëtejme të Komisionit, siç janë ristrukturimi i Komisioneve, hartimi i fjalorthit parlamentar, përcaktimit të gjuhës parlamentare dhe jo parlamentare, çështjen e betimit të deputetëve, çështjen e deklarimit të grupeve parlamentare dhe deputetëve dhe të pyetjeve parlamentare.

Ramadan Gashi ngriti çështjen e betimit të deputetëve duke cekur se do ishte mirë që edhe deputetet e rinj të cilët kanë ardhur më vonë të bënin betimin.

Kryetari në fjalën e tij lidhur me pyetjet parlamentare, tha që të ato të lihen për fundin e seancës plenare, pasi që edhe në Republikën e Shqipërisë kjo praktikë ka treguar sukses. Po ashtu i njoftojë deputetët se në Asamblenë Nacionale të Francës për pyetjet parlamentare organizohet seancë e veçantë.

Ahmet Isufi duke u ndërlidhur me parafolësin ndau mendimin se pyetjet parlamentare nëse lihen për fundin e seancës do të mungojnë ministrat. Përkrahi idenë e organizimit të një seancë të veçantë për pyetje parlamentare, por që kjo të mundësohet do duhej që të amendamentohet Rregullorja e Kuvendit. Në vazhdim ai theksoi se do të duhej ti sugjerohet Kryetarit të Kuvendit që mos të komentojë vazhdimisht Rregulloren e Kuvendit sepse nuk ka mundësi që çdo herë ka interpretoj drejt, por do të duhet ta thërras Kryetarin e Komisionit për Rregullore që edhe ai të jap interpretimin e tij ngase është më i thirrur ta bëjë këtë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe Kolë Berisha, Ramadan Gashi dhe Vladimir Todorovic

Kryetari pas diskutimeve konstatoi se Komisioni, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Ti rekomandohet Kryesisë së Kuvendit që të shqyrtojë mundësinë e zhvendosjes së kohës për pyetjet parlamentare, të paraparë në nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, dhe të përcaktohet një nga këto propozime:

- *Pyetjet parlamentare të shtrohen në fund të seancës plenare;*
- *Pyetjet parlamentare të shtrohen pas pauzës së drekës;*
- *Të mbahet seancë e veçantë për pyetjet parlamentare.*

5. Të ndryshme.

Nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E hartoi:

Njësia për mbështetje të Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Hydajet HYSENI -KALOSHI